



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.1465/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “SHKOZA FO7- COMPANY”, me seli ne Prishtine, te cilën me autorizim e përfaqëson N.K., avokat ne Malishevë, ndaj debitorit Komuna e Malishevës, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës – Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.711/22 te datës 10.05.2023, me datën 05.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e debitorit Komuna e Malishevës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.711/22 te datës 10.05.2023, Vërtetohet.

**Arsyetim**

Gjykata Komerciale e Kosovës – Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.711/22 te datës 10.05.2023, e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Malishevës, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.30/21 dt.14.05.2021 te Përmbaruesit Privat Ymer Kastrati, për territorin e Gjykatës Themelore ne Gjakovë dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.30/21 dt.14.05.2021.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes esenciale te dispozitave te procedurës, vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe urdhrin përmbarimor te shfuqizoj.

Ndërsa kreditori, ka ushtruar përgjigje ne ankese me pretendimin qe ankesa te refuzohet ne tërësi si e pabazuar.

Dhoma e Shkalles se Dytë, e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pabazuar.**

-

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori më datën 14.05.2021, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës 03/2021 të dates 24.02.2021, e cila ka derivuar nga raporti kontraktual nr.74 e dates 16.11.2020

Përbaruesi Ymer Kastrati, për territorin e Gjykatës Themelore ne Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përbarimor P.nr.30/21 dt.14.05.2021, ka lejuar përbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga fatura, t'i paguaj shumën prej 11,860.10 Euro,

Kundër urdhrin përbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 21.05.2021, arsyetimin se debitori nuk i ka pranuar faturat ne menyre te rregullt, me tej ka kundërshtuar duke theksuar se nuk janë ne dijeni te borxhit te pretenduar dhe nuk kemi pranuar faturën ne origjinal dhe me tej ne kundërshtime debitori e ka kundërshtuar rregullsinë e faturës, dhe me këtë pretendon se kreditori ka vepruar ne mënyrë te kundërligjshme duke mos zbatuar nenin 21 dhe nenin 29 par.1.3 te LPP. Propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, urdhrin përbarimor ta shfuqizoj si edhe te gjitha veprimet përbarimore.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit, ka paraqitur kreditori me datën 21.05.2021, me pretendimin se arsyet e paraqitura ne prapësim nuk qëndrojnë dhe janë thjeshtë arsye për zvarritjen e procedurës se përbarimit dhe mos përmbushjes se detyrimit, po ashtu ka theksuar se pikërisht kjo fature e cila kundërshtohet nga debitori është ne pajtim me ligjin dhe se i është dorëzuar debitorit me kohe. Propozimi për përbarim i ka te gjitha tiparet e përbarueshmërisë duke u bazuar ne nenin 29 te LPP, debitori nuk ka ofruar asnjë provë ne bazë te cilës e mbështet prapësimin, andaj propozon qe gjykata ta refuzoj si te pabazuar prapësimin e debitorit dhe ta obligoj debitorin ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.711/22 te datës 10.05.2023 me të cilin e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përbarimor duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Gjykata arsyeton se fatura mbi te cilën bazohet propozimi për përbarim i plotësonë te gjitha kushtet ligjore konform nenit 29 dhe 37 te LPP. Pra urdhri përbarimor bazohet ne dokument te besueshëm, vlerëson se nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore te parapara me nenin 71 te LPP, andaj konform nenit 71 dhe 73 te LPP ka vendos si ne dispozitiv te vendimit te saj.

Dhoma e Shkalles e Dytë, e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës

kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton edhe sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaremore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të Faturës 03/2021 të datës 24.02.2021, (e cila ka derivuar nga raporti kontraktual nr.74 e datës 16.11.2020), të lëshuar nga kreditori, në mbështetje të nenit 29 par.3 i LPP i cili thotë, se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, kjo faturë ka cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe e njëjta si e tillë paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 21 të njëjtit ligj. Propozimi për përmbarim i ushtruar nga kreditori, po ashtu rezulton të jetë në pajtim me nenin 37 të LPP-së e cila thotë se *“kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimi të bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Në rastin konkret Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK e as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në bazë të dokumentit të besueshëm, te cilën kreditori ia ka bashkëngjitur me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbarim, janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit dhe se kjo faturë ligjërisht paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit.

Gjykata e shkallës së dytë analizoi edhe pretendimet e debitorit se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejt provat e paraqitura nga ana e te paditurës, ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike e njëkohësisht ka zbatuar gabimisht te drejtën materiale, por vlerësoi se këto pretendime nuk qëndrojnë, sepse debitori nuk i ka argumentuar me prova konkrete ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, dhe se te tilla nuk ndikojnë në një vendosje ndryshe për çka kjo gjykatë i refuzoi si te pabazuara, ndërsa aktvendimin e gjykatës e shkallës së parë e vërtetoi.

Përndryshe, në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkalles së Dytë  
K.DH.SH.II nr.1465/23 me datë 05.03.2024**

**Gjyqtari,  
Faton Bajrami**